



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 27, datë 18/03/2022

MBI

“PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË TË ARDIURAVE TË INSTITUCIONIT DHE SHITIMIN E RREGJISTRIT TË PROKURIMEVE PËR VITIN KALENDARIK 2022, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Arsimit nr. 27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe pasi shqyrtoi Relacionin e Administratores së Universitetit të Arteve Zuj. Alma Sinanaj dhe pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Propozimin për miratimin e shpërndarjes së të ardhurave të institucionit, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2022, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Propozimin për miratimin e shtimit të rregjistrit të prokurimeve, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2022, sipas tabelës nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim ti dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve për miratim.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSIA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Sindi ZDRAVA (Studente FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ADMINISTROR

Nr. 12 prot.

Tiranë, më 17/03/2022

Propozim për shpërndarjen e të ardhurave rregjistrin e prokurimit për vitin 2022

Senatit Akademik të Universitetit të Arteve

Për vitin 2022, Universiteti i Arteve, ka parashikuar të realizojë të ardhurat me vlerë 42.106.194 lek. Burimet e krijimit të të ardhurave janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Burimet e krijimit	Vlera (lek)
1	Tarifa Shkollimi	36,777,790
2	Tarife konkurrimi & rregjistrimi	2,163,600
3	Sherbim salle	500,000
4	Qera ambjente	2,364,804
5	Diploma, vërtet., shtypshk etj	300,000
	Te ardhura UART	42,106,194

Në vijim do të paraqesim shpjegimet për zërat e tabelës së mësipërme:

- Zëri “Tarifa shkollimi” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga tarifat e shkollimit përcaktuar në vendimet përkatëse për këtë qëllim. Parashikimi i këtyre të ardhura është bazuar në numrin e studentëve, të cilët janë rregjistruar dhe do të paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik 2021-2022, numër i cili është 837 studentë, nga të cilët 499 studentë të rregjistruar në Ciklin e Parë dhe vlera e parashikuar të arketohet do të jetë 12.688.000 lek dhe 338 studentë në ciklin e dytë dhe vlera e parashikuar të arketohet do të jetë 24.089.790 lek .
- Zëri “Tarifë konkurrimi & rregjistrimi” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat, që sipas vendimeve të organeve drejtuese të UART për këtë qëllim parashikohen të realizohen nga konkurset e pranimit dhe tarifat e rregjistrimit, që realizohen për aplikantët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në UART.
- Zëri “Shërbim salle” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga kontratat e shërbimit (“Black Box”, “Cesk Zadeja”, “Galeria e FAB”) subjekteve private dhe shtetërore. Në planifikimin e këtij zëri jemi bazuar duke marrë në konsideratë situatën e krijuar nga Covid-19 si dhe që Salla e Madhe ka filluar rikonstruktimin.
- Zëri “Qera ambjente” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga dhënia me qera e ambjeteve të UART. Në planifikimin e këtij zëri jemi bazuar në 3 kontrata që janë për dhënie me qera të ambjeteve të UART.
- Zëri “Diploma, vërtetetime, shtypshkrime etj” – në këtë zë janë përfshirë të ardhurat që parashikohen të realizohen nga tarifat që aplikohen për marrjen e diplomave nga ana e

Adresa: Ziv. “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë Shqipëri. Tel +355 42 225 488. www.uart.edu.al






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

studentëve , nga vërtetimet e ndryshme. Parashikimi është bazuar në realizimin e vitit 2022.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur pesha specifike që zë cdo burim krijimi i të ardhurave në raport me të ardhurat totale që parashikohen të realizohen për vitin 2022.



Duke marrë në konsideratë, të ardhurat e parashikuara të realizohen për vitin 2022, si dhe ato të trashëguara nga viti 2021, me vlerë 28.762.774 lek, propozojmë që të ardhurat të shpërndahen si në tabelën e mëposhtme.

Nr. llog.	Emertimi	Shpenzime (lek)
231	Investime	44,856,545
600	Paga	11,684,189
601	Sigurime	1,516,170
602	Mallra dhe sherbime	12,411,464
606	Rimbursim telefon	400,600
	TOTALI	70,868,968

Në vijim paraqiten shpjegimet për zërat e tabelës së mësipërme:

- Investime** – në këtë zë janë përfshirë investimet e përcaktuara në vitin 2021, të cilat janë parashikuar të realizohen në vitin 2022 me vlerë 27.918.720 lek. Pavarësisht se, gjatë vitit 2021 procedurat e prokurimit u realizuan, nuk pati fitues. Ndërsa vlera 16.937.825 lek është parashikuar për investime për vitin 2022, por nuk është detajuar në zëra mbasi njësitë e UART janë në fazën e përcaktimit të tyre.
- Paga** – në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për paga për punonjësit me kontratë (personeli akademik i ftuar 12.205 orë) për vitin akademik 2021-2022 si dhe personeli me kontratë bazuar në vendimet e SA dhe BA.






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. **Sigurime shoqërore dhe shëndetësore** në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për shpenzimet e parashikuara në zërin paga.
4. **Mallra dhe shërbime** – në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pagesën e tarifave të akreditimit (11.211.464 lek) si dhe materiale për aktivitet që do të zhvillohen për 60-vjetorin e Fakultetit të Muzikës (1.200.000 lek).
5. **Rimbursime** - në këtë zë janë përfshirë rimbursimi i tarifës së shkollimit për studentët, të cilët e kanë paguar tarifën e shkollimit, por me pas, me vendim të BA, kanë përfitur nga reduktim/përfshirje të saj si dhe shpenzimet telefonike për titullarët, kjo bazuar në vendimet përkatëse.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur pesha specifike që zë çdo shpenzim në raport me shpenzimet totale që parashikohen të realizohen për vitin 2022.



A. Kujaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Tabela Nr.1

Shpërndarja e të ardhura të UA për vitin 2022

Nr. Ilog.	Emertimi	Shpenzime (lek)
231	Investime	44,856,545
600	Paga	11,684,189
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,516,170
602	Mallra dhe shërbime	12,411,464
606	Rimbursime	400,600
	TOTALI	70,868,968

Tabela Nr.2

Rregjistri i prokurimeve me burim financimi të ardhurat e UA për vitin 2022.

Nr. Ilog.	Emertimi	Kap.6 (lek)
231	Instalime elektrike	1,700,600
231	Pajisje audivizuale	2,695,910
231	Pajisje teknike	11,099,576
231	Rikonstruksion	960,000
231	Vegla muzikore	8,262,634
231	Kondicioner	1,200,000
231	Shtesë anësore (rikonstruksion)	2,000,000
602	Tarifa per akreditimin	11,211,464
602	Përvjetori i 60 FM	1,200,000
	TOTALI	40,330,184

